

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BUTARI" sh.p.k."

Sot, me date 10 janar 2023, ne te nenshkruarit:

- Z.Hamza Koleci , Shtetas Shqiptare, lindur ne Lam i madh ,Burrel , Shqiperi me 13.01.1967 dhe banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identitetit me numer: G70113072I , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar) kemi vendosur te themelojmr nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar "BUTARI" sh.p.k (me poshte referuar si "Shoqeria"), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte "BUTARI" Sh.p.k"

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: "Qarku Diber , Rrethi Mat ,Bashkia Burrel ,Njesia administrative Derjan , Fshati Lam I madh .Toke PF me zone kadastrale 2378 Nr pasurie 311
Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon: Prodhim energjie me panele voltaike.Prodhim dhe shitje energjie me panele diellore fotovoltaike.

Neni 5

1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1 00 000 (Njeqind mije) leke.
2. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre si me poshte:
 - Ortaku themelues Z. Hamza Koleci Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100000 (Njeqindmije) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise;

Ortaku i Shoqerise mund te vendosin te rrisin kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Detyrimet e ortakeve te shoqerise kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij.

Neni 6

Shoqeria vepron nen rregjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

- Asambleja e Pergjithshme;
- Administratori;

Kompetencat e Asmblëse së Përgjithshme si dhe të administratorit të Shoqërisë janë të parashkruara në Statutin e Shoqërisë.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretet, e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i shoqërisë.

Neni 8

Mardhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që ta respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demot që shkaktojnë kësaj Shoqërie me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9

Në rast se Shoqëria do të mbyllë aktivitetin e saj për çdo lloj arsye, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të Shoqërisë, përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e Shoqërisë i besohet një eksperti kontabel. Ky ekspert do të emërohet dhe qendroje në detyrë sipas parashikimeve që bën ligji për ekspertet dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Përgjithshme cakton edhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

Neni 11

Viti financiar fillon në 1 Janar dhe mbaron në 31 dhjetor të secilit vit. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 dhjetor. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilancëve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të ceshtjeve të mesipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do të kalojnë ortakëve të Shoqërisë.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe. Për sa është shprehur në këtë Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar).

**ORTAKET
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"BUTARI" sh.p.k."

Hamza Proceci
